



**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 25, datë 25.09.2024

**PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:
“HOTEL 3 KATE MBI TOKË DHE 4 KATE NËNTOKË ME PISHINË”, ME
VENDNDODHJE NË KSAMIL, BASHKIA SARANDË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjekti zhvillues shoqërisë “Epidamn - C” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Hotel 3 kat mbi tokë, 4 kat nëntokë me pishinë”, me vendndodhje në Ksamil, Bashkia Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “EPIDAMN - C” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Sarandë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LËNJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT


MIRELA KUMBARO TURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 1964 / 2025